



Ne baze te nenit 12, paragrafi 1 dhe 2, shkronja (d) nenit 17, paragrafi 1, shkronja (c) të Ligjit Nr-03/L-040, për Vetëqeverisjen Lokale, “Gazeta zyrtare e Republikës së Kosovës, Nr-28/2008”, nenit 10, pika 1.5, te Ligjit Nr-04/L-144, për dhënie ne shfrytëzim dhe këmbimin e pronës se paluajtshme te Komunës, “Gazeta zyrtare e Republikës së Kosovës, Nr-35/2012”, nenit 20, pika 7 dhe 11, të Rregullores QRK, Nr-23/2013, për përcaktimin e procedurave të dhënies në shfrytëzim dhe këmbimit të pronës së paluajtshme të Komunës, Kuvendi i Komunës në Suharekë në mbledhjen e mbajtur me datën, 27.06.2018, miratoi këtë:

V E N D I M
PËR CAKTIMIN E LOKACIONIT PËR VENDOSJEN E TRAFOSTACIONEVE
DHE DHËNIEN NË SHFRYTËZIM AFATGJATË TË PRONËS SË
PALUAJTSHME TË KOMUNËS

Neni 1

Me këtë vendim caktohet lokacioni për vendosjen e trafostacionit TS nga KEDS-si dhe dhënia në shfrytëzim afatgjatë të pronës së paluajtshme të Komunës, si më poshtë:

Në fshatin Nishor në parcelën kadastrale **P-72116031-03320-0**, me sipërfaqe të përgjithshme prej; **15703m²**, sipas certifikatës së pronës **nr. 301-2018**, datës 30.04.2018, zona kadastrale **Nishor**, vendi i quajtura **“Brinja Breg”**, e evidentuar pasuri shoqërore rrugë në emër të Kuvendit Komunal-Suharekë, nga sipërfaqja e përgjithshme e cekur më lart ndahen **9m²** për vendosjen e trafostacionit.

Neni 2

Pronat e cekura në neni 1, të këtij vendimi jepen në shfrytëzim pa kompensim në afat për 99 (nëntë dhjetë e nëntë) vite.

Neni 3

3.1 OBLIGOHET shfrytëzuesi i cekur në **nenin 1**, të këtij vendimi, që pronën e paluajtshme, ta shfrytëzon me mirëbesim si nikoqir i mirë, që mos t’ia humbë vlerën e saj.

3.2 Prona e paluajtshme në fjalë nuk e ndërron titullarin juridik, pronarë i saj mbetet Kuvendi Komunal i Suharekës dhe si e tillë ajo nuk mund t’i epet personit të tretë në shfrytëzim nga ana e shfrytëzuesit, nuk mund të tjetërsohet, nuk mund të jetë objekt i ndonjë barre tatimore apo çfarëdo ngarkese tjetër mbi këtë pronë.

3.3 Komuna e Suharekës e ruan të drejtën kur do herë që sipas nevojës për realizimin e interesave publik të Komunës të ndryshoj lokacionin në një vend tjetër.